

**Raport i Komisionit recensues për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët Marketingu i turizmit; Marketing menaxhment dhe Bazat e marketingut, drejtuar Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit ekonomik të Universitetit të Tetovës.**

Ne bazë të konkursit të shpallur më datë 10 Prill të vitit 2021, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, Këshillit mësimor shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 21 Prill 2021, sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-388/1, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët, **Marketingu i turizmit; Marketing menaxhment dhe Bazat e marketingut**, në përbërje:

1. **Prof.dr. Etem Iseni**, Profesor ordinar, Fakulteti ekonomik, Universiteti i Tetovës,
2. **Prof.dr. Sofronija Miladinovski**, Profesor ordinar, Fakulteti i turizmit në Ohër,
3. **Prof.dr. Katerina Angelevska-Najdeska** Profesor ordinar, Fakulteti i turizmit në Ohër,

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat:

1. **Prof.Dr. Raman Ismaili**, me Fletë aplikimi nr. 04/02/14. të datës 14.04.2021.

Komisioni pasi që konstaton se dosja e aplikimit përmban të gjithë dokumentacionin e rregullt të paraparë në konkurs, paraqet:

**Raport recensues**

Me datë 10.04.2021, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat” është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Ekonomik, në thirrjen mësimore-shkencore, për lëndët: **Bazat e marketingut, Marketingu i turizmit dhe Marketing menaxhment**. Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit Prof.Dr. Raman Ismaili, komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë;

**1. Të dhëna biografike**

**Raman Ismaili** është i lindur më 25.01.1966 në fshatin Sellarcë të Epërme të Tetovës. Shkollimin fillor e ka kryer në fshatin e lindjes. Shkollimin e mesëm e mbaron në vitin 1985 në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” të Tetovës, Drejtimi i përgjithshëm.

Studimet bazike i kryen në Fakultetin e Turizmit dhe hotelerisë në Ohër, pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”, në Manastir dhe fiton titullin „**Menaxher i diplomuar në fushën e turizmit,**”.

Po në të njëjtin institucion në vitin 2007 regjistron studimet e magjistraturës. Pasi që përfundon provimet (mesatare 9.33), kandidati me sukses mbron temën e magjistraturës me titull: „**Strategjia e marketingut për plasmanin e produktit hotelier në rajonin e Strugës,**” dhe fiton gradën shkencore „**Magjistër i shkencave në fushën e turizmit dhe hotelerisë,**”.

Në vitin 2011, kandidati në Fakultetin e Turizmit në Ohër me sukses mbron disertacionin e doktoratës, me titull: „**Çmimet si përcaktues të avantazhit konkurrues të ndërmarrjeve hoteliere të rajonit të Ohrit dhe Strugës,**” dhe fiton gradën shkencore „**Doktor i shkencave në fushën e Turizmit dhe hotelerisë,**”.

Kandidati Prof.dr. Raman Ismaili me Vendim nr. 04-4319/1, të datës 27 Tetor të vitit 2016, është zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, e që nga viti 2010 vazhdon të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

## 2. Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore

Angazhimi në mësimdhënie dhe veprimtari arsimore i kandidatit **Prof.dr. Raman Ismaili** është tejet i begatshëm. Në fakt, në mësimdhënie është i përfshirë në të tri ciklet e studimit, brenda dhe jashtë vendit, Në ciklin e parë të studimeve në Fakultetin ekonomik të Universitetit të Tetovës, kandidati ka realizuar një fond të konsiderueshëm të leksioneve në lëndët Bazat e marketingut, Marketingu i turizmit, dhe Biznesi ndërkombëtar. Në cilësinë e Profesorit vizitor, në Fakultetin e Suboticës, në departamentin e Bujanocit, ka ligjruar lëndët Ekonomia ndërkombëtare dhe Ekonomia e ndërmarrjes. Në vazhdimësi, kontributi i kandidatit në mësimdhënie ka vazhduar edhe në ciklin e dytë të studimeve, ku ka realizuar leksione në lëndët Marketing menaxhmenti bashkëkohor, Strategjitë e marketingut ndërkombëtar, Lidërshipi dhe ndryshimet organizative dhe Marketingu strategjik i avancuar. Nga të dhënat e mësipërme, rezultojnë të jetë realizuar një gamë e gjerë në fusha të ngushta lëndore, ku kandidati ka kontribuar në përgatitjen profesionale të studentëve.

Përpos mësimdhënies, në veprimtarinë arsimore kandidati ka realizuar obligime pedagogjike siç janë konsultat me student; udhëheqje shkencore në nivele të Studimeve deridiplomike, pjesëmarrje në vlerësim dhe mbrojtje të temave në Studimet Master; udhëheqje shkencore në nivel të Studimeve Master, pjesëmarrje në vlerësim dhe mbrojtje të temave në Studime të doktoratës. Ai gjithashtu është anëtar i Komisioneve recensuese për zgjedhje-rizgjedhje për bashkëpunëtor dhe mësimdhënës. Gjithashtu, është një nga recensentët të tekstit Universitar „Qeverisja e korporatave,, të autorit Prof.dr. Brikend Aziri, i botuar nga Qendra e botimeve të Universitetit të Tetovës në vitin 2020. Vlen të përmendet se me Vendim të Senatit të Universitetit të Novi Sadit, nr. 08-2863, të datës 29.09.2019, **Prof.dr. Raman Ismaili** është zgjedhur në thirrje **Profesor vizitues**.

Në bazë të kriterëve për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje dhe rizgjedhje, si pjesë përbërëse e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për zgjedhje dhe rizgjedhje në thirrje mësimore/shkencore, kandidati **Prof.dr. Raman Ismaili** në veprimtarinë e mësimdhënies dhe asaj arsimore, ka grumbulluar gjithsej **103,3 pikë**.

## 3. Veprimtaria shkencore/hulumtuese

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit **Prof.dr. Raman Ismaili** përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare si dhe me pjesëmarrje në tubime të ndryshme shkencore dhe profesionale. Kjo veprimtari kryesisht është përfshirë si më poshtë:

1. Punime të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare (ISSN),

- **Raman Ismaili**, Brikend Aziri, „Brand Management In The Hospitality Industry In The Republic Of Macedonia,, Conference Proceedings Book 1, Modern Science Volume IV. Economics & Tourism, ISSN 2367-5659, 2017.
- Brikend Aziri, Raman Ismaili, „The Changing Nature Of Leadership,, Conference Proceedings Book 1, Modern Science Volume V. Economics & Tourism, ISSN 2367-5659, 2017.
- Brikend Aziri, **Raman Ismaili**, Etem Iseni, „The Leader’s Role In Fostering And Managing Organizational Changes,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.1. ISSN 2545-4439 fopr printed version, 2017.
- Sheherzada Murati, **Raman Ismaili**, Isak Ajruli,, Comparing Free And Paid App Versions In The Amazon App Store Using Opinion Analysis,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.2. ISSN 2545-4439, For printed version, 2017.

- **Raman Ismaili**, Brikend Aziri, Etem Iseni, „Online Promotion: An Underdeveloped Tool In The Pollog Region,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.2. ISSN 2545-4439 for printed version, 2017.
- Armend Pushkule, **Raman Ismaili**, „Analysis Of The Number Of Tourists And Nights Spent In The Republic Of Macedonia For The Period 2004-2014,, Economic Vision Vol. 4, No 7-8. 2017, ISSN 1857-9566.
- Besnik Fetaj, Nora Sadiku-Dushi, **Raman Ismaili**, Measuring The Impact Of Extrinsic Cuen On Consumers' Purchasing Decision For Food Products, Studia Universitatis Babes-Bolyai Oeconomica, Volume 62, Issue 3, 2017, PP 33-46. DOI: 10.15.15/subboec- 2017-0012.
- **Raman Ismaili**, Brikend Aziri, „Marketing Strategies Among Companies In The Pollog Region,, Economic Vision Vol. 5, No 9-10. 2018, ISSN 1857-9566.
- **Raman Ismaili**, Brikend Aziri, Aida Yzeiri Baftijari, „ Marketing research among companies in pollog region,, Economic Vision Vol. 6, No 11-12. 2019, ISSN 1857-9566.
- Aida Yzeiri Baftijari, **Raman Ismaili**, Brikend AZIRI, „Client expectations and preferences for service quality dimensions in bank services in republic of north Macedonia,, Economic Vision Vol. 7, No 13-14. 2020, ISSN 1857-9566.
- Brikend AZIRI, **Raman Ismaili**, „Business environment analysis as a key stage in the process of strategic management,, Economic Vision vol, 7, No 13/14, 2020, ISSN 1857 – 9566.,

2. Punime me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhje punimesh nga takime shkencore/profesionale, (ISBN),

- Amali Çipi, **Raman Ismaili**, „Rethinking Board Evaluation: Recent Trends In Albanian Corporate, The 6-Thinternational,, Multidisciplinary Conference Ictea-28-30 April 2017 Vol.1. The Science Today Is The Future's Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. publisher: Epict Albania.
- Enida Pulaj (Brakaj), **Raman Ismaili**, „Analyzing Industry Competitiveness. A Multi Criteria Framework,, The 6-Thinternational Multi Disciplinary Conference Ictea-2017 Vol.1. The Science Today Is The Future's Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. Publisher: Epict Albania. April 2017.
- Florian Miti, **Raman Ismaili**, „Regulation By Contract,, The 6-Thinternational Multidisciplinary conference Ictea-2017 Vol.1. The Science Today Is The Future's Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. Publisher: Epict Albania. April 2017.
- **Raman Ismaili**, Brikend Aziri, „Cilësia E Arsimit Të Lartë Dhe Tregu I Punës Në Republikën E Maqedonisë,, Akademia E Shkencave Dhe E Arteve E Kosovës, Copright ASHAK, 2019.

3. Pjesëmarrje në Konferenca ndërkombëtare,

- „Implementation Of Marketing In Function Of Improvement Of Business Performance Of Travel Agencies In The Region Of Tetovo,, 4th international Scientific Conference,, The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, Isbn 978-608-217-049-7, December 2016.
- „Direct Marketing Min Function Of Using The Capacities Of Hotels,, 4th International Scientific Conference,, The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, Isbn 978-608-217-049-7, December 2016.

- „Making Business Decisions: Challenges For Companies In The Pollog Region „5th International Conference Of The Faculty Of Economics And The Faculty Of Business Administration „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, Isbn 978-608-217-065-7, December 2017.
  - „Marketing Strategies Of SME’s In The Pollog Region,, 5th International Conference Of The Faculty Of Economics And The Faculty Of Business Administration „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, Isbn 978-608-217-065-7, December 2017.
  - „Marketing Research Among Companies In The Pollog Region,, 6th International Scientific Conference , Economic Development As A Precondition For EU Integration,, Edpeui2018, Isbn 978-608-217-072-5, 19-20 October, 2018.
  - „Strategic Planning In Contemporary Marketing,, 7th International Scientific Conference On Topic „Contemporary Economic Trends Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019
  - „Business Environment Analysis As A Key Stage In The Process Of Strategic Management,, 7th International Scientific Conference On Topic „Contemporary Economic Trends Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019.
  - „Credit Risk And Credit Risk Management In Transition Countries With Special Account In The Republic Of North Macedonia,, 7th International Scientific Conference On Topic „ Contemporary Economic Trends,, Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019.
4. Pjesëmarrje në panel diskutime shkencore/profesionale,
- "Determining the priorities of economic development in the Republic of Macedonia" Faculty of Economics, University of Tetova, April 2018.
  - „Towards balanced regional development,, Faculty of Economics in Subotica, department in Bujanovac, 2018.
  - „The Challenges of the Economic Development of the Tourist Destination Sunny Hill,, Faculty of Economics, University of Tetova, April 2019.
  - „Privatization in the transition process,, Faculty of Economics in Subotica, department in Bujanovac, 2019.
  - "Impact of the pandemic on national economies" Faculty of Economics, University of Tetova, May 2020.
5. Libra të botuar në fushën profesionale,
- Brikend Aziri, **Raman Ismaili**, „**Strategy: A Necessity for Companies in the Republic of North Macedonia**,, LAMBERT ACADEMIC PUBLISHING, 2020, **ISBN: 978-6202554398**.
  - Halit Shabani, Brikend Aziri, **Raman Ismaili**, Ibish Mazreku „**Qeverisje korporative: Qeverisja me shoqëritë aksionare në Republikën e Kosovës**,, Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, 2021, **ISBN 978-9951-672-19-1**.

Në bazë të kriterëve për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje dhe rizgjedhje, si pjesë përbërëse e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për zgjedhje dhe rizgjedhje në thirrje mësimore/shkencore, kandidati **Prof.dr. Raman Ismaili** në veprimtarinë shkencore/hulumtuese dhe në veprimtarinë e aplikuar profesionale ka grumbulluar gjithsej **119.2 pikë**.

#### 4. Veprimtaria me interes të gjerë

Veprimtarinë me interes më të gjerë të kandidatit **Prof.dr. Raman Ismaili** e përfshinë një sërë aktivitetesh të radhitura si më poshtë:

1. Redaktor reviste shkencore/profesionale ndërkombëtare,
  - Redaktor i revistës shkencore „Economic vizion,, Volumi 3, nr. 5-6, 2016. Volumi 4, nr. 7-8, 2017. Volumi 5, nr. 9-10, 2018. Volumi 6, nr. 11-12, 2019. Volumi 7, nr. 13-14, 2020.
2. Anëtar Bordi editorial,
  - Anëtar i Bordit editorial në revistën shkencore „Economic vizion,, Volumi 3, nr. 5-6, 2016. Volumi 4, nr. 7-8, 2017. Volumi 5, nr. 9-10, 2018. Volumi 6, nr. 11-12, 2019. Volumi 7, nr. 13-14, 2020.
3. Anëtar Bordi shkencor ose organizativ në Konferencë ndërkombëtare,
  - The 4th International Scientific „, The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, ISBN 978-608-217-049-7, organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration University of Tetova, December 2016.
  - The 5th International Scientific „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, ISBN 978-608-217-065-7, organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration University of Tetova, December 2017.
  - The 6th International Scientific Conference „Economic development as a precondition for integration in the European Union,, organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration University of Tetova, Tetor 2018.
  - The 7th International Scientific Conference “Contemporary Economic Trends” – CET2019, organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration University of Tetova and Faculty of Economics, Management and Accountancy, University of Malta, 13 – 15 November, 2019 at University of Tetova, Macedonia.
  - The 2th International Conference „Sustainable Development,, (ICSD-2016), October 19 - 23, 2016 in Skopje, Macedonia.
4. Dekan në Fakultet,
  - Dekan në Fakultetin Ekonomik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2019-
5. Anëtar komisioni për zgjedhje në thirrje mësimore,
  - Anëtar në 11 Komisione për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje mësimore.

Në bazë të kriterëve për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje dhe rizgjedhje, si pjesë përbërëse e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për zgjedhje dhe rizgjedhje në thirrje mësimore/shkencore, kandidati **Prof.dr. Raman Ismaili** në veprimtarinë me interes të gjerë ka grumbulluar gjithsej **32 pikë**.

Në bazë të Kriterëve për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrje mësimore/shkencore, si pjesë përbërëse e Rregullores për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrje mësimore/shkencore në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. Dr. Raman Ismaili** nga të gjitha aktivitetet e parapara, ka realizuar gjithsej **254.5 pikë**.

#### Përfundim dhe propozim

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur dhe vlerësimit të arritjeve të paraqitura në raport, Komisioni recensues konstaton se kandidati **Prof.dr. Raman Ismaili** i plotëson të gjitha kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të parapara me Ligjin për Arsim të lartë, Statutin e UT-së,

Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe thirrje të bashkëpunëtorëve, si dhe aktet e tjera normative, për t'u zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore **Profesor Ordinar**.

Pas një përfundimi me vlerësim pozitiv, Komisioni recensues ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Ekonomik t'i propozojë që kandidati **Prof.dr. Raman Ismaili** të zgjidhet në thirrje mësimore/shkencore **Profesor ordinar** për lëndët: **Marketingu i turizmit, Marketing menaxhment dhe Bazat e marketingut**.

Tetovë, Maj 2021.

Komisioni recensues:

1. Prof.dr. Etem Iseni \_\_\_\_\_
2. Prof.dr. Sofronija Miladinovski \_\_\_\_\_
3. Prof.dr. Katerina Angelevska-Najdeska \_\_\_\_\_

## 5. Shtojcë:

Formulari i referencave për zgjedhje në thirrje mesimore/shkencore,

Kandidati: Prof.dr. Raman Ismaili.

Institucioni: Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës.

Lëmi Shkencorë: Marketingu i Turizmit,

Tabela nr. 1: Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore			
	Aktiviteti	Kalkulimi	Pikët
<b>1.</b>	<b>Leksione të realizuara në Ciklin e parë</b>		
<b>1.1.</b>	<b>Viti akademik 2016/2017</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b>		
	▪ <b>Semestri dimëror:</b>	3x12x0.04	1.44
	Financa dhe kontabilitet, Sem. V, 3+2		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. II, 3+2		
	Biznes ndërkombëtar, Sem. IV, 2+2		
	<b>Marketingu i turizmit</b>		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. VIII, 2+1	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. IV, 3+2		
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b>		
	▪ <b>Semestri dimëror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Financa dhe kontabilitet, Sem. III, 2+1		
	Biznes Ndërkombëtar, Sem. V, 2+2		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. IV, 3+2		
<b>1.2.</b>	<b>Viti akademik 2017/1018</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b>		
	▪ <b>Semestri dimëror:</b>	3x15x0.04	1.8
	Financa dhe kontabilitet, Sem. V, 3+2		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. II, 3+2		
	Biznes ndërkombëtar, Sem. IV, 2+2		
	<b>Marketingu i turizmit</b>		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. VIII, 2+1	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. IV, 3+2		
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b>		
	▪ <b>Semestri dimëror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Financa dhe kontabilitet, Sem. III, 2+1		
	Biznes Ndërkombëtar, Sem. V, 2+2		
	▪ <b>Semestri veror:</b>	2x15x0.04	1.2
	Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04	1.8
	Turizëm, Sem. IV, 3+2		

<b>1.3.</b>	<b>Viti akademik 2018/2019</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> <b>▪ Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. V, 3+2 Marketing dhe menaxhment, Sem. III, 3+2 <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Biznes ndërkombëtar, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04  2x15x0.04	1.8  1.2
	<b>Marketingu i turizmit</b> <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. VIII, 2+1 Turizëm, Sem. IV, 3+2	2x15x0.04 3x15x0.04	1.2 1.8
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> <b>▪ Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. III, 2+1 Biznes Ndërkombëtar, Sem. V, 2+2 <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Turizëm, Sem. IV, 3+2	2x15x0.04  2x15x0.04 3x15x0.04	1.2  1.2 1.8
<b>1.4.</b>	<b>Viti akademik 2019/2020</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> <b>▪ Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. V, 3+2 Marketing dhe menaxhment, Sem. III, 3+2 <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Biznes ndërkombëtar, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04  2x15x0.04	1.8  1.2
	<b>Marketingu i turizmit</b> <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. VIII, 2+1 Turizëm, Sem. IV, 3+2	2x15x0.04 3x15x0.04	1.2 1.8
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> <b>▪ Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. III, 2+1 Biznes Ndërkombëtar, Sem. V, 2+2 <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Turizëm, Sem. IV, 3+2	2x15x0.04  2x15x0.04 3x15x0.04	1.2  1.2 1.8
<b>1.5.</b>	<b>Viti akademik 2020/2021</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> <b>▪ Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. V, 3+2 Marketing dhe menaxhment, Sem. III, 3+2 <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Biznes ndërkombëtar, Sem. IV, 2+2	3x15x0.04  2x8x0.04	1.8  0.64
	<b>Marketingu i turizmit</b> <b>▪ Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. VIII, 2+1	2x8x0.04 3x8x0.04	0.64 0.96



	Turizëm, Sem. IV, 3+2		
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Semestri dimëror:</b> Financa dhe kontabilitet, Sem. III, 2+1 Biznes Ndërkombëtar, Sem. V, 2+2 ▪ <b>Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, Sem. IV, 2+2 Turizëm, Sem. IV, 3+2	2x15x0.04  2x8x0.04 3x8x0.04	1.2  0.64 0.96
<b>2.</b>	<b>Leksione të realizuara në Ciklin e dytë</b>		
<b>2.1.</b>	<b>Viti akademik 2017-2018</b>		
	Strategjitë e marketingut ndërkombëtar Marketing menaxhmenti bashkëkohor	5x0.05 5x0.05	0.25 0.25
<b>2.2.</b>	<b>Viti akademik 2018-2019</b>		
	Marketingu strategjik i avancuar Marketing menaxhmenti bashkëkohor	20x0.05 5x0.05	1.0 0.25
<b>2.3.</b>	<b>Viti akademik 2019-2020</b>		
	Lidershipi dhe ndryshimet organizative Marketing menaxhmenti bashkëkohor	10x0.05 5x0.05	0.5 0.25
<b>2.4.</b>	<b>Viti akademik 2020-2021</b>		
	Lidershipi dhe ndryshimet organizative	20x0.05	1.0
<b>3.</b>	<b>Leksione të realizuara në Ciklin e tretë</b>		
<b>3.1.</b>	<b>Viti akademik 2017/2018</b>		
	Biznesi ndërkombëtar		
<b>4.</b>	<b>Konsulta të realizuara me studentë</b>		
<b>4.1.</b>	<b>Viti akademik 2016/2017</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 74 studentë, Turizëm, 25 studentë, Biznes ndërkombëtar, 18 studentë.	117x0.002	0.234
	<b>Marketingu i turizmit</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Ekonomi dhe biznes, 62 studentë Turizëm, 25 studentë	87x0.002	0.174
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 74 studentë Biznes Ndërkombëtar, 18 studentë Ekonomi dhe biznes, 62 studentë Turizëm, 25 studentë	199x0.002	0.398
<b>4.2.</b>	<b>Viti akademik 2017/2018</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 44 studentë Ekonomi dhe biznes, 39 studentë Turizëm, 31 studentë Biznes ndërkombëtar, 16 studentë	130x0.002	0.26
	<b>Marketingu i turizmit</b> ▪ <b>Semestri veror:</b> Ekonomi dhe biznes, 39 studentë		

	Turizëm, 31 studentë	70x0.002	0.14
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 44 studentë Biznes Ndërkombëtar, 16 studentë Ekonomi dhe biznes, 39 studentë Turizëm, 31 studentë	130x0.002	0.26
<b>4.3.</b>	<b>Viti akademik 2018/2019</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 33 st. Marketing dhe menaxhment, 49 st. Ekonomi dhe biznes, 28 st. Biznes ndërkombëtar, 12	122x0.002	0.244
	<b>Marketingu i turizmit</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Ekonomi dhe biznes, 28 st. Turizëm, 14 st.	42x0.002	0.084
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 33 st Biznes Ndërkombëtar, 12 st. Ekonomi dhe biznes, 28 st. Turizëm, 14 st.	87x0.002	0.174
<b>4.4.</b>	<b>Viti akademik 2019/2020</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 34 st. Marketing dhe menaxhment, 40 st. Ekonomi dhe biznes, 30 st. Biznes ndërkombëtar, 6 st.	110x0.002	0.22
	<b>Marketingu i turizmit</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Ekonomi dhe biznes, 30 st. Turizëm, 12 st.	42x0.002	0.084
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 34 st. Biznes Ndërkombëtar, 6 st. Ekonomi dhe biznes, 30 st. Turizëm, 12 st.	82x0.002	0.164
<b>4.5.</b>	<b>Viti akademik 2020/2021</b>		
	<b>Bazat e marketingut,</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 40 st. Marketing dhe menaxhment, 30 st.	70x0.002	0.14
	<b>Biznesi ndërkombëtar</b> ▪ <b>Programi studimor:</b> Financa dhe kontabilitet, 40 st. Biznes Ndërkombëtar, 15 st.	55x0.002	0.11

<b>5.</b>	<b>Anëtar komisioni për vlerësim ose mbrojtje në Master</b>		
	Anëtar komisioni për vlerësim ose mbrojtje të temave Master në Fakultetin ekonomik, në 34 komisione,	14x1	14
<b>6.</b>	<b>Udhëheqës shkencor në Studime të magjistraturës</b>		
	Mentor në 6 tema të mbrojtura të magjistraturës në F. Ekonomik	6x1	6
<b>7.</b>	<b>Recensent libri Universitar</b>		
	Prof.dr. Brikend Aziri, „Qeverisja e korporatave,, Botoi UT, 2020.	1x4	4
<b>8.</b>	<b>Recensent në zgjedhje/rizgjedhje për bashkëpunëtor dhe mësimdhënës</b>		
	Anëtar në Komision recensues për zgjedhje rizgjedhje, 8 kanidat.	8x1	8
<b>9.</b>	<b>Profesor vizitues jashtë vendit</b>		
	Universiteti në Novi Sad, Fakulteti ekonomik i Suboticës, 2019/20.	1x8	8
<b>10.</b>	<b>Anëtar komisioni për vlerësim ose mbrojtje të Doktoratës</b>		
	Pjesëmarrje në 9 komisione Dokorate	9x2	18
	<b>Totali i pikëve në mësimdhënie dhe veprimtarinë arsimore</b>		<b>103.3</b>

**Tabela Nr. 2: Veprimtaria shkencore dhe hulumtuese**

<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Kalkulimi</b>	<b>Pikët</b>
<b>1.</b>	<b>Udhëheqës shkencor në ciklin e tretë të studimeve të Doktoratës</b>		
	▪ Mentor të Doktorantëve, Mr.sc. Lumnije Sinani, Mr. sc.Adem Qorrolli dhe Mr. sc.Elhami Hajdari.	3x4	12
<b>2.</b>	<b>Mentor në ciklin e dytë të studimeve Master</b>		
	▪ Mentor në Master tek 6 kandidatë	6x2	12
<b>3.</b>	<b>Punim me rezultate shkencore origjinale, i publikuar në revistë shkencore/profesionale të indeksuara me Bord redaktues ndërkombëtar) ISSN.</b>		
	▪ <b>Raman Ismaili</b> , Brikend Aziri, „Brand Management In The Hospitality Industry In The Republic Of Macedonia,, Conference Proceedings Book 1, Modern Science Volume Iv. Economics &Tourism, ISSN 2367-5659, 2017.	90%	5.4
	▪ Brikend Aziri, Raman Ismaili, „The Changing Nature Of Leadership,, Conference Proceedings Book 1, Modern Science Volume V. Economics &Tourism, ISSN 2367-5659, 2017.	90%	5.4
	▪ Brikend Aziri, <b>Raman Ismaili</b> , Etem Iseni, „The Leader’s Role In Fostering And Managing Organizational Changes,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.1. ISSN 2545-4439, for printed version, 2017.	80%	4.8
	▪ Sheherzada Murati, <b>Raman Ismaili</b> , Isak Ajruli , „Comparing Free And Paid App Versions In The Amazon App Store Using Opinion Analysis,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.2. ISSN 2545-4439 fopr printed version, 2017.	80%	4.8
	▪ <b>Raman Ismaili</b> , Brikend Aziri, Etem Iseni, „Online Promotion: An Underdeveloped Tool In The Pollog Region,, Knowledge, International Journal Scientific papers Vol. 17.2. ISSN 2545-4439 for printed version, 2017.	80%	4.8

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Armend Pushkule, <b>Raman Ismaili</b>, „Analysis Of The Number Of Tourists And Nights Spent In The Republic Of Macedonia For The Period 2004-2014,, Economic Vision Vol. 4, No 7-8. 2017, ISSN 1857-9566.</li> <li>▪ Besnik Fetaj, Nora Sadiku- Dushi, <b>Raman Ismaili</b>, Measuring The Impact Of Extrinsic Cuen On Consumers’ Purchasing Decision For Food Products, Studia Universitatis Babes-Bolyai Oeconomica, Volume 62, Issue 3, 2017, PP 33-46. DOI: 10.15.15/subboec- 2017-0012.</li> <li>▪ <b>Raman Ismaili</b>, Brikend Aziri, „Marketing Strategies Among Companies In The Pollog Region,, Economic Vision Vol. 5, No 9-10. 2018, ISSN 1857-9566.</li> <li>▪ <b>Raman Ismaili</b>, Brikend Aziri, Aida Yzeiri Baftijari, „ Marketing research among companies in pollog region,, Economic Vision Vol. 6, No 11-12. 2019, ISSN 1857-9566.</li> <li>▪ Aida Yzeiri Baftijari, <b>Raman Ismaili</b>, Brikend AZIRI, „Client expectations and preferences for service quality dimensions in bank services in republic of North Macedonia,, Economic Vision Vol. 7, No 13-14. 2020, ISSN 1857-9566.</li> <li>▪ Brikend AZIRI, <b>Raman Ismaili</b>, „Business environment analysis as a key stage in the process of strategic management,, Economic Vision vol, 7, No 13/14, 2020, ISSN 1857 – 9566.,</li> </ul>	90%	5.4
		80%	4.8
		90%	5.4
		80%	4.8
		80%	4.8
		90%	5.4
<b>4.</b>	<b>Punim me rezultate shkencore origjinale, i publikuar në përmbledhje punimesh në takim shkencor/profesional, ISBN.</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Amali Çipi, <b>Raman Ismaili</b>, „Rethinking Board Evaluation: Recent Trends In Albanian Corporate, The 6-Thinternational, Multidisciplinary Conference Ictea-28-30 April 2017 Vol.1. The Science Today Is The Future’s Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. publisher: Epict Albania.</li> <li>▪ Enida Pulaj (Brakaj), <b>Raman Ismaili</b>, „Analyzing Industry Competitiveness. A Multi Criteria Framework, The 6-Thinternational Multi Disciplinary Conference Ictea-2017 Vol.1. The Science Today Is The Future’s Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. publisher: Epict Albania. April 2017.</li> <li>▪ Florian Miti, <b>Raman Ismaili</b>, „Regulation By Contract,, The 6-Thinternational Multidisciplinary conference Ictea-2017 Vol.1. The Science Today Is The Future’s Solution. Isbn: 978-9928-4374-7-1. publisher: Epict Albania. April 2017.</li> <li>▪ Raman Ismaili, Brikend Aziri, „Cilësia E Arsimit Të Lartë Dhe Tregu I Punës Në Republikën E Maqedonisë,, Akademia e Shkencave dhe e Arteve E Kosovës, Copiright Ashak, 2019.</li> </ul>	90%	1.8
		90%	1.8
		90%	1.8
		90%	1.8
<b>5.</b>	<b>Konferenca Ndërkombëtare</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ „Implementation Of Marketing In Function Of Improvement Of Business Performance Of Travel Agencies In The Region Of</li> </ul>		

	<p>Tetovo,, 4th international Scientific Conference,, The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, Isbn 978-608-217-049-7, December 2016.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ „Direct Marketing Min Function Of Using The Capacities Of Hotels,, 4th international Scientific Conference,, The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, Isbn 978-608-217-049-7, December 2016.</li> <li>▪ „Making Business Decisions: Challenges For Companies In The Pollog Region „5th International Conference Of The Faculty Of Economics And The Faculty Of Business Administration „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, Isbn 978-608-217-065-7, December 2017.</li> <li>▪ „Marketing Strategies Of SME’s In The Pollog Region,, 5th International Conference Of The Faculty Of Economics And The Faculty Of Business Administration „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, Isbn 978-608-217-065-7, December 2017.</li> <li>▪ „Marketing Research Among Companies In The Pollog Region,, 6th International Scientific Conference, Economic Development As A Precondition For EU Integration,, Edpeui2018, Isbn 978-608-217-072-5, 19-20 October, 2018.</li> <li>▪ „Strategic Planning In Contemporary Marketing,, 7th International Scientific Conference On Topic „Contemporary Economic Trends Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019</li> <li>▪ „Business Environment Analysis As A Key Stage In The Process Of Strategic Management,, 7th International Scientific Conference On Topic „Contemporary Economic Trends Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019.</li> <li>▪ „Credit Risk And Credit Risk Management In Transition Countries With Special Account In The Republic Of North Macedonia,, 7th International Scientific Conference On Topic „Contemporary Economic Trends Isbn-978-608-217-079-4, 13-15 November 2019.</li> </ul>	8x1	8
<b>6.</b>	<b>Pjesëmarrje me referat në tubim shkencorë</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ "Determining the priorities of economic development in the Republic of Macedonia" Faculty of Economics, University of Tetova, April 2018.</li> <li>▪ „Towards balanced regional development,, Faculty of Economics in Subotica, dep. in Bujanovac, 2018.</li> <li>▪ „The Challenges of the Economic Development of the Tourist Destination Sunny Hill,, Faculty of Economics, University of Tetova, April 2019.</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ „Privatization in the transition process,, Faculty of Economics in Subotica, dep. in Bujanovac, 2019.</li> <li>▪ "Impact of the pandemic on national economies" Faculty of Economics, University of Tetova, 2020.</li> </ul>	5x2	10
<b>Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore hulumtuese</b>		<b>100.2</b>

**Tabela nr. 3: Veprimtaria e aplikuar profesionale**

Aktiviteti		Kalkulimi	Pikët
<b>1.</b>	<b>Libër i botuar në fushë profesionale</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Brikend Aziri, <b>Raman Ismaili</b>, „Strategy: A Necessity for Companies in the Republic of North Macedonia,, Lambert Academic Publishing, 2020, ISBN: 978-6202554398</li> <li>▪ Halit Shabani, Brikend Aziri, <b>Raman Ismaili</b>, Ibish Mazreku „Qeverisje korporative: Qeverisja me shoqëritë aksionare në Republikën e Kosovës,, Fakulteti i biznesit, Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë. ISBN: 978-9951-672-19-1, Biblioteka kombëtare e Kosovës „Pjetër Bogdani,, Shtypshkronja Iliri, 2021 Prishtinë.</li> </ul>	2x7	14
<b>2.</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete promovionale</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizator dhe pjesëmarrës i aktiviteteve promovionale të fakultetit, Tetovë, 2017,2018, 2019, 2020.</li> <li>▪ Pjesëmarrës në aktivitete promovionale Bujanoc, 2019.</li> </ul>	5x1	5
<b>Totali i pikëve në veprimtarinë e aplikuar profesionale</b>			<b>19</b>

**Tabela nr. 4: Veprimtaria me interes të gjerë**

Aktiviteti		Kalkulimi	Pikët
<b>1.</b>	<b>Redaktor reviste shkencore/profesionale ndërkombëtare</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Redaktor i revistës shkencore „Economic vizion,, Volumi 3, nr. 5-6, 2016. Volumi 4, nr. 7-8, 2017. Volumi 5, nr. 9-10, 2018. Volumi 6, nr. 11-12, 2019. Volumi 7, nr. 13-14, 2020.</li> </ul>	5x2	10
<b>2.</b>	<b>Anëtar i bordit editorial</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Anëtar i bordit editorial në revistës shkencore „Economic vizion,, Volumi 3, nr. 5-6, 2016. Volumi 4, nr. 7-8, 2017. Volumi 5, nr. 9-10, 2018. Volumi 6, nr. 11-12, 2019. Volumi 7, nr. 13-14, 2020.</li> </ul>	5x1	5
<b>3.</b>	<b>Anëtar Bordi shkencor/organizativ në konferenca ndërkombëtare</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ The 4th International Scientific „ The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans,, ISBN 978-608-217-049-7, organized by: Faculty of Economics &amp; Faculty of Business Administration University of Tetova,December 2016.</li> <li>▪ The 5th International Scientific „Challenges Of Doing Business In The Contemporary World,, ISBN 978-608-217-065-7,</li> </ul>		

	organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration University of Tetova, December 2017.		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>The 6th International Scientific Conference „Economic development as a precondition for integration in the European Union,, organized by: Faculty of Economics &amp; Faculty of Business Administration University of Tetova, Tetor 2018.</li> </ul>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>The 7<sup>th</sup> International Scientific Conference “Contemporary Economic Trends” – CET2019, organized by: Faculty of Economics &amp; Faculty of Business Administration University of Tetova and Faculty of Economics, Management and Accountancy</li> <li>University of Malta, 13 – 15 November, 2019 at University of Tetova, Macedonia.</li> </ul>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>The 2th International Conference „Sustainable Development,, (ICSD-2016), October 19 - 23, 2016 in Skopje Macedonia.</li> </ul>	5x1	5
<b>4.</b>	<b>Dekan në Fakultet</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dekan në Fakultetin Ekonomik, UT, 2019-</li> </ul>	1x6	6
<b>5.</b>	<b>Anëtar komisioni për zgjedhje në thirrje mësimore</b>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Anëtar në 11 zgjedhje rizgjedhje të stafit akademik</li> </ul>	12x0.5	6
<b>Totali i pikëve në veprimtarinë profesionale aplikative</b>			<b>32</b>

<b>Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhje në thirrje mësimore/shkencore</b>	
<b>Veprimtaria</b>	<b>Pikët</b>
Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore	103.3
Veprimtaria shkencore hulumtuese	100.2
Veprimtaria e aplikuar profesionale	19
Veprimtaria me interes më të gjerë	32
<b>Gjithsej</b>	<b>254.5</b>

Tetovë, Maj 2021.

Komisioni recensues:

1. Prof.dr. Etem Iseni \_\_\_\_\_

2. Prof.dr. Sofronija Miladinovski \_\_\_\_\_

3. Prof.dr. Katerina Angelevska-Najdeska \_\_\_\_\_

## **RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRJET MËSIMORE – SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më: 10.04.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden pecat” si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), Këshilli mësimor – shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më datë 21.04.2021 solli Vendim me nr 14-389/1, për caktim të komisionit recenzues për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: **Makroekonomi, Ekonometri dhe Ekonomi e investimeve** (në programet studimore: Ekonomi dhe biznes, Financë dhe kontabilitet, Marketing dhe menaxhment dhe Turizëm), në përbërje

1. **Prof.dr.Raman Ismaili, kryetar:** *profesor inordinar*, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, Tetovë
2. **Prof.dr. Gazmend Qorraj, anëtar:** *profesor ordinar*, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
3. **Prof.dr.Arun Tahiri, anëtar:** *profesor inordinar*, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, Tetovë.

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartë përmendur, dhe në përputhje me nenin 132 të Ligjit për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 35/2008, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurë për zgjedhje-rizgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës këtë:

### **RECENZION**

Me datë 10.04.2021 në gazetën „Koha”, *Sloboden pecat*” dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Ekonomik për lëndët: **Makroekonomi, Ekonometri dhe Ekonomi e Investimeve** (në programet studimore: Ekonomi dhe biznes, Financë dhe kontabilitet, Marketing dhe menaxhment, Biznes ndërkombëtar dhe Turizëm). Komisioni në fjalë, konstatoi se në konkurs, kandidat i vetëm është paraqitur **Doc.Dr. Bardhyl Dauti**, aktualisht i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, në thirrjen mësimore – shkencore, *docent*, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës. Komisioni recensues mendimin e vet e arsyeton në vazhdim të këtij raporti recensues.

#### **1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL**

Bardhyl Dauti është i lindur më 04.08.1982 në Tetovë. Shkollimin fillor e kryen në shkollën fillore: Gjergj Kastrioti Skenderbeu, F. Xhepcisht, Tetovë, ndërsa shkollimin e mesëm e kryen në vitin 2001 pranë gjimnazit Kiril Pejcinoviq – Tetovë, në drejtimin Matematik-Natyrorë. Studimet themelore i kryen në vitin 2005, në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë, Universitetin e Evropës Juglindore - Tetovë. Studimet e magjistraturës, i përfundon në vitin 2007, në drejtimin: *Ekonomiks për analiza të biznesit (Economics for Business Analysis)*, në Universitetin Staffordshire (Staffordshire University), - Mbretëri e Bashkuar, Stoke on Trent të Anglisë. Studimet e doktoraturës i përfundon në Fakultetin Ekonomik, në drejtimin *Ekonomi (Economics)*, në vitin 2015, në Universitetin e Lubjanës, Slloveni. Pas mbrojtjes së tezës së disertacionit të doktoraturës: **“Determinants and Trade Effects of Foreign Direct Investment in South East European**



*Countries, with special reference to Macedonia" (Determinantët dhe efektet tregtare të Investimeve të Huaja Direkte në vendet e Evropës juglindore, me theks të veçantë në Maqedoni),* më datë 10.06.2015, gradohet me titullin shkencor: *Doktor i shkencave ekonomike, profili ekonomiks.* Studimet themelore, Bardhyl Dauti, i ka të përfunduar në gjuhën shqipe, ndërsa studimet e magjistraturës dhe doktoraturës në gjuhën angleze.

Bardhyl Dauti, është punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, në Universitetin e Tetovës, në Mars të vitit 2006, në thirrjen mësimore shkencore, *asistent i ri.* Në Shkurt të vitit 2013 gradohet në thirrjen mësimore shkencore, *asistent,* ndërsa në Shtator të vitit 2016 merr thirrjen mësimore shkencore *docent,* në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës. Dr.Bardhyl Dauti është visiting profesor në Universitetin e Novi Sadit, Fakultetin Ekonomik në Suboticë, Serbi, me ç'rast ka realizuar aktivitete të mësimdhënies në vitin akademik 2020/2021, në semestrin veror. Dr.Bardhyl Dauti, gjithashtu posedon thirrje të **visiting profesor** për lëndët: *Makroekonomi Ndërkombëtare dhe Makroekonomi,* në Universitetin e Ljublanës, Fakultetin Ekonomik, thirrje e cila i vlen deri në vitin akademik 2024/2025. Kandidatit Doc.Dr. Bardhyl Dauti është i dëshmuar edhe në aktivitete profesionale të karakterit më të gjerë publik, përgjatë përvojës së tij institucionale në organet legjislative dhe ekzekutive të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2016 u zgjodh deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa në vitin 2018 u emërua ministër për Investime të Huaja, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mandat të cilin e ushtroi për dy vite, deri në Gusht të vitit 2020.

## **2. VEPRIMTARIA MËSIMORE - ARSIMORE**

Doc. Dr. Bardhyl Dauti, përgjatë periudhës së viteve akademike 2016/17-2020/21, pas marrjes së thirrjes mësimore-shkencore, *docent,* në ciklin deridiplomik ka ligjëruar në lëndët: Makroekonomi, Sistemet Ekonomike Bashkëkohore, Kërkime Operacionale, Menaxhimi Operacional dhe Statistikë, në të gjitha programet studimore të Fakultetit Ekonomik. Veprimtaria mësimore arsimore e kandidatit në fjalë është e begatshme dhe e frytshme, duke u përfshirë në mësimdhënie si brenda po ashtu edhe jashtë vendit si viziting profesor. Doc.Dr.Bardhyl Dauti, gjithashtu ka një kontribut të madh edhe në mentorimin e studentëve në studimet e ciklit të parë dhe merr pjesë aktive edhe në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të temave deridiplomike. Në ciklin e dytë, ai, ka ligjëruar lëndët: Ekonomi Rurale dhe Auditimi në sektorin publik. Duke vazhduar të realizoj me përgjegjësi maksimale detyrimet pedagogjike në ciklin e dytë, përpos mentorimit të kandidatëve, mer pjesë edhe në disa komisione për vlerësim dhe mbrojtje të temave të magjistraturës në Fakultetin ekonomik, me ç'rast jep kontribut vital në përsosje të tezave të magjistraturave, të kandidatëve, në drejtim të modelimit ekonometrik dhe orientimit metodologjik të tyre. Në përputhje me rregulloren dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Doc.Dr.Bardhyl Dauti ka realizuar gjithsej **94.53** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

## **3. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati Doc.Dr.Bardhyl Dauti, është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e shkencave ekonomike, respektivisht të ekonomiksit. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit, pas marrjes së thirrjes *docent,* përbëhet nga gjashtë artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me rezultate origjinale, tre prej të cilëve janë të indeksuara në **web of science.** Hulumtimet e trajtuara përgjatë

punimeve shkencore ngërthejnë tema të politikës fiskale, tregtisë ndërkombëtare, investimeve të huaja dhe konvergencës ekonomike. Punimi i fundit i kandidatit në fjalë është nga fusha e politikës fiskale në Bashkimin Evropian: *Cyclicity of Fiscal Policy in the European Union; (Ciklikaliteti i politikës fiskale në Bashkimin Evropian)*, punim ky i botuar në revistën prestigjioze: *Romanian Journal of Economic Forecasting, me faktorimpakti 0.756*. Në fushën e politikës fiskale, që përbën një prej fushë trajtimeve kyçe të lëndës së Makroekonomisë, kandidati Doc.Dr. Bardhyl Dauti, ka të publikuar edhe kapitull libri me temën *Fiscal Policy of the European Union (Politika fiskale në Bashkimin Evropian)*, në librin *European Union and the Western Balkans, (Bashkimi Evropian dhe Ballkani perendimor)*, libër ky i edituar nga **Prof. Dr. Iraj Hashi (Universiteti Staffordshire)** dhe **Prof.Dr.Gazmend Qorraj(Universiteti i Prishtinës)**.

Veprimtaria hulumtuese e kandidatit në fjalë ngërthen edhe tema tjera të natyrës makroekonomike, nga fusha e tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve të huaja direkte. Në këtë kontekst, kandidati në fjalë, në vitin 2016 boton një punim të rëndësishëm empirik me rezultate origjinale nga fusha e tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve të huaja direkte, në revistën prestigjioze rajonale *Proceedings of Rijeka Faculty of Economics: Journal of Economics and Business, 34(1), 63-89*, në Universitetin e Rijekës – Kroaci, revistë kjo e indeksuar në *web of science dhe me faktor impakti 1.02*. Me pak fjalë, në këtë punim, kandidati trajton një mostër voluminoze vendesh duke përfshirë dy kategori grup vendesh; 20 vende të OECD-së, në njërën anë dhe 5 vende të Evropës Juglindore dhe 10 vende të Evropës Qendrore, në anën tjetër. Vendet e OECD-së në punim trajtohen si vende origjinë të IHD-ve të lokalizuara në vendet e EJL-së dhe EQ-së dhe vende importuese, njëkohësisht; ndërsa vendet e EJL-së dhe EQ-së, në punim trajtohen si vende nikoqir të IHD-ve dhe vende eksportuese. Modelimet ekonometrike të punimeve në fjalë shërbehen me metoda të avancuara ekonometrike të panelit fiks, dinamik dhe jolinear; si metoda të efekteve fikse duke përfshirë edhe variabla fiktive, metoda *System GMM* dhe metoda *Poisson Pseudo-Maximum Likelihood Estimation*. Nga fusha e ekonometrisë financiare, kandidati jep kontribut vital edhe në një punim tjetër të titulluar si *Insolvency Risk Prediction Using Logit and Logistic models*, punim ky i publikuar në revistë të indeksuar në **web of science**, konkretisht në revistën *Economic Computation & Economic Cybernetics Studies & Research 51, no. 4*.

Doc.Dr. Bardhyl Dauti, përgjatë periudhës 2017-2021 publikon edhe tre punime me rezultate origjinale në revistën **Economic Vision** të Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tetovës, duke trajtuar tema të konvergencës makroekonomike të Maqedonisë së Veriut në drejtim të Bashkimit Evropian dhe tema që lidhen me faktorët makroekonomik dhe institucional të tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve të huaja direkte. Veprimtaria hulumtuese e kandidatit Doc.Dr.Bardhyl Dauti, është paraqitur si më poshtë:

#### **Publikime në revista të njohura me bord editorial ndërkombëtar**

1. Dauti, B. (2016). Trade and foreign direct investment: Evidence from South East European countries and New European Union member states *Proceedings of Rijeka Faculty of Economics: Journal of Economics and Business, 34(1), 63-89. Indexed in web of science.*
2. Dauti, B; *et al.*, (2017) "Insolvency risk prediction using the logit and logistic models: some evidences from Romania." *Economic Computation & Economic Cybernetics Studies & Research 51, no. 4 Indexed in web of science*

3. Dauti, B. (2018). Substitutionary or complementary relationship between foreign direct investment and exports. Evidence from transition countries. *Economic Vision, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, 5(9-10), 20-30. **Indexed in EBSCO, google scholar**
4. Dauti, B., & Emini, E. (2019). Economic challenges of North Macedonia is bridging toward European Union, with focus on real and nominal convergence. *ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, 6(11-12), 31-41. **Indexed in EBSCO, google scholar**
5. Dauti, B. (2020). Institutional determinants of foreign direct investment flows in transition economies. *Economic vision-International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, 7 (13-14), 71-86. **Indexed in EBSCO, google scholar**
6. Dauti, B; *et al* (2020). Cyclicity of Fiscal Policy in the European Union. *Romanian Journal of Economic Forecasting*, 23(1), p.75. **Indexed in web of science**

#### **Kapitull libri**

1. Dauti, Bardhyl (2020). Fiscal Policy of the European Union, in Qorraj, G. & Hashi, I. (eds). *European Union and the Western Balkans*.

Doc. Dr. Bardhyl Dauti, përgjatë përvojës së tij profesionale si ministër i Investimeve të Huaja Direkte, realizon disa paraqitje plenare profesionale para auditoriumit ndërkombëtar, duke referuar për tema të rëndësishme që lidhen me performancën makroekonomike të Maqedonisë së Veriut dhe perspektivën Euro-Integruese të vendit. Një prej referimeve më të rëndësishme është ai i paraqitur në **Cascais** të Portugalisë, me ç'rast në një kohëzgjatje prej 30 minutave, referon në temën: *Catalyzing the benefits of globalization – The future of innovation in globalized world. (Katalizimi i benefiteve të globalizimit – E ardhmja e inovacioneve në një botë të globalizuar)*. Në **South Bank, në Londër** të Britanisë së Madhe, para një auditoriumi ndërkombëtar, referon në temën: *Investing in Europe: what is the perception of the European market by international companies looking to invest in Europe (Investimi në Europë: Cili është perceptimi për tregjet evropiane nga kompanitë shumëkombëshe)*. Përgjatë veprimtarisë së tij profesionale, Doc.Dr.Bardhyl Dauti, ka referuar edhe në tre evenimente të organizuar nga fondacioni *Berghof dhe asociacioni i Evropës Juglindore*, për temat respektive: **1)** Reforma e mediave në Maqedoni (Korrik, 2017; **Ljublane**, Slloveni), **2)** Sfidat ekonomike për integrimin Euroatlantik të Maqedonisë (Nëntor, 2017; **Berlin**- Gjermani) dhe **3)** Imagjinimi i rrugëve të reja propozuese – ekonomike të Maqedonisë (Maj, 2018; **Vienë**-Austri).

Kandidati Doc.Dr.Bardhyl Dauti, ka participuar edhe në ligjërata me thirrje nga **Universiteti Illinois** në Urbana Campaign, **Sh.B.A**, duke referuar në një kohëzgjatje prej 30 minutave në temën: *Recreation and Tourism Economics (Ekonomiksi i rekreacionit dhe turizmit)*. Në dy raste ka participuar edhe në debate shkencore të organizuar nga Fakulteti Ekonomik, në rastin e parë duke referuar në temën: *Zhvillimi Ekonomik, parakusht për integrim në BE*, në vitin 2018 dhe në rastin e dytë duke referuar në temën: *Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë nacionale*, mbajtur më 22 Maj të vitit 2020.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati **Doc.Dr.Bardhyl Dauti** ka realizuar gjithsej **67.8** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

#### **4. VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE**

Veprimtaria profesionale aplikative e kandidatit Doc.Dr. Bardhyl Dauti, mund të ngërthehet në kuadër të aktiviteteve si më poshtë:

1. Dauti, Bardhyl (2020). Fiscal Policy of the European Union, in Qorraj, G. & Hashi, I. (eds). European Union and the Western Balkans; book chapter (kapitull libri).
2. Evaluim të 6 punimeve shkencore të dorëzuara për publikim në revistën: *Economic Vision*, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and *Tourism*, 6(Vëllimi 6).
3. Koordinator në përgatitje të elaboratit për programin studimor Ekonomi-Biznes, Fakulteti Ekonomik, 2021.

Në përputhje me rregulloren dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati **Doc.Dr.Bardhyl Dauti** ka realizuar gjithsej **17** pikë nga veprimtaria profesionale-aplikative.

#### **5. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË**

Veprimtaria me interes më të gjerë e kandidatit Doc.Dr.Bardhyl Dauti, mund të ngërthehet në kuadër të aktiviteteve si më poshtë:

1. Anëtar Bordi shkencor ose organizativ në dy tubime shkencore - konferencë.
2. Anëtar Bordi organizativ në tre vëllime te revistë shkencore/profesionale *Economic Vision*.
3. Anëtar komisioni për zgjedhje/rizgjedhje në tre thirrje mësimore-shkencore
4. Anëtar i forumit ndërkombëtar për hulumtime ne tregti ndërkombëtare; F.R.E.I.T (Forum for research in empirical international trade).
5. Anëtar i komisionit parlamentar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për asocim dhe stabilitet i Republikës së Maqedonisë, viti 2016.
6. Anëtar i komisionit për çështje ekonomike në qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti 2018.

Në përputhje me rregulloren dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Doc.Dr. Bardhyl Dauti ka realizuar gjithsejtë **12.5** pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.

## 6. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati **Doc.Dr.Bardhyl Dauti** ka grumbulluar gjithsej **191.83 pikë**, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **94.53**, veprimtarinë shkencore-hulumtuese **67.8 pikë**, veprimtarinë profesionale-aplikative **17 pikë** dhe veprimtarinë me interes më të gjerë **12.5 pikë**.

FORMULARI I PIKEVE NË TOTAL		
I	Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore – arsimore	<b>94.53</b>
II	Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore hulumtuese	<b>67.8</b>
III	Totali i pikëve nga veprimtaria profesionale aplikative	<b>17</b>
IV	Totali i pikëve nga veprimtaria me interes më të gjerë	<b>12.5</b>
	<b>Totali i pikëve (I+II+III+IV)</b>	<b>191.83</b>

### PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në **shtojcë**, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Doc.Dr.Bardhyl Dauti**, në përputhje me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), ka tubuar gjithsej **191.83 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka tejkaluar numrin minimal, prej **80 pikëve** që duhet të realizohen për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, komisioni konstaton se **Doc. Dr. Bardhyl Dauti** ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni recensues pa mëdyshje ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë këshillit shkencorë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës, që kandidati **Doc. Dr. Bardhyl Dauti** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore, **Profesor Inordinar** për lëndët **Makroekonomi, Ekonometri dhe Ekonomi e investimeve** (në programet studimore: Ekonomi biznes, Financë dhe kontabilitet, Marketing dhe menaxhment, Biznes ndërkombëtar dhe Turizëm, të Fakultetit Ekonomik).

Tetovë, 29.04.2021

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES

1.Kryetar

2, Anëtar

3, Anëtar

## SHTOJCË

<b>I. VEPRIMTARIA MESIMORE-ARSIMORE</b>			
Numri rendor	Emri i aktivitetit	Pikët e kalkuluara	Pikët në total
	<b>CIKLI I PARË</b>		
	<b>MBAJTJA E LIGJERATAVE</b>	<b>0.04</b>	
A	<i>Makroekonomi</i>		
B	<i>Kërkime Operacionale</i>		
C	<i>Menaxhimi Operacional</i>		
D	<i>Statistike</i>		
E	<i>Sistemet Ekonomik Bashkëkohore (Tetove+Shkup)</i>		
1	<b>Viti akademik (2020/2021)-Semestri veror</b>		
1B	Kërkime Operacionale (2+2) – Ekonomi-Biznes	2x15x0.04	1,2
1B	Kërkime Operacionale (3+2)-Kontabilitet Finance	3x15x0.04	1,8
1B	Menaxhimi Operacional (2+2)-Biznes Ndërkombëtar	2x15x0.04	1,2
1E	Sistemet Ekonomike (2+1)-(Biznes Ndërkombëtar)	2x15x0.04	1,2
2	<b>Viti akademik (2020/2021)-Semestri Dimëror</b>		
2D	Statistike (3+2) –Marketing Menaxhment	3x15x0.04	1,8
2A	Makroekonomi (4+3) – Ekonomi-Biznes	4x15x0.04	2,4
3	<b>Viti akademik (2019/2020)-Semestri Veror</b>		
3B	Kërkime Operacionale (3+2)-Kontabilitet Finance	3x15x0.04	1,8
3C	Menaxhimi Operacional (2+1)-Biznes Ndërkombëtar	2x15x0.04	1,2
3E	Sistemet Ekonomike (2+1)-(Biznes Ndërkombëtar)	2x15x0.04	1,2
4	<b>Viti akademik (2019/2020)-Semestri Dimëror</b>		
4A	Makroekonomi (4+3) – Ekonomi-Biznes	4x15x0.04	2,4
4E	Sistemet Ekonomike Bashkëkohore (2+1) - Shkup	2x15x0.04	1,2
5	<b>Viti akademik (2018/2019)-Semestri Dimëror</b>		
5B	Kërkime Operacionale (3+2)-Kontabilitet Finance	3x15x0.04	1,8
5C	Menaxhimi Operacional (2+1)-Biznes Ndërkombëtar	2x15x0.04	1,2
5E	Sistemet Ekonomike (2+1)-(Biznes Ndërkombëtar)	2x15x0.04	1,2
6	<b>Viti akademik (2017/2018)-Semestri Veror</b>		
6B	Kërkime Operacionale (3+2)-Kontabilitet Finance	3x15x0.04	1,8
6C	Menaxhimi Operacional (2+1)-Biznes Ndërkombëtar	2x15x0.04	1,2
6E	Sistemet Ekonomike (2+1) - (Biznes Ndërkombëtar)	2x15x0.04	1,2
6	<b>Viti akademik (2017/2018)-Semestri Dimëror</b>		
6A	Makroekonomi (3+2)-Marketing-Menaxhment	3x15x0.04	1,8
6E	Sistemet Ekonomike Bashkëkohore (2+1)-Shkup	2x15x0.04	1,2
7	<b>Viti akademik (2016/2017) – Semestri Veror</b>		
7C	Menaxhimi Operacional (2+1)-Biznes Ndërkombëtar	2x15x0.04	1,2
7E	Sistemet Ekonomike (2+1)-(Biznes Ndërkombëtar)	2x15x0.04	1,2
<b>1-7</b>	<b>Totali i pikëve për ligjërata në ciklin bachelor</b>		<b>31.2</b>
	<b>CIKLI I DYTË (Të gjithë programet studimore)</b>		
F	Ekonomia Rurale (semestri veror, viti akademik 2018/2019)	2×10×0.05	1
G	Auditimi ne sektorin publik (semestri dimëror, 2019/2020)	2×10×0.05	1
<b>F+G</b>	<b>Totali i pikëve për ligjërata në ciklin master</b>		<b>2</b>
8	<b>MENTORIM I MESIMIT PRAKTIK</b>	30x0.06	1.8
<b>8T</b>	<b>Totali i pikëve për mentorim të mësimit praktik</b>		<b>1.8</b>
9	<b>PERGADITJA E LËNDËS SË RE</b>		

9.1	Ligjërata (6x1=6) (A+B+C+D+E+F+G)	6x1	
<b>9T</b>	<b>Totali i pikëve për përgatitje të lëndës së re</b>		<b>6</b>
<b>10</b>	<b>KONSULTIME ME STUDENTËT</b>		
10.1	Makroekonomi (Ekonomi-Biznes)	94x0.002x3	0.56
10.2	Makroekonomi (Marketing-Menaxhment)	60x0.002x3	0.36
10.2	Kërkime Operacionale (Finance-Kontabilitet)	85x0.002x5	0.85
10.3	Kërkime Operacionale (Ekonomi-Biznes)	35x0.002x4	0.24
10.4	Sistemet Ekonomike Bashkëkohore (Biznes-Ndërkombëtar)	50x0.002x4	0.40
10.5	Menaxhimi Operacional	65x0.002x4	0.52
10.6	Statistike	80x0.002x1	0.16
10.7	Ekonomi Rurale	10x0.002x2	0.04
10.8	Auditimi	5x0.002x2	0.20
<b>10.T</b>	<b>Totali i pikëve për konsultime me studentët</b>		<b>3.33</b>
<b>11</b>	<b>Skriptë interne për ligjerata</b>		
11.1	Makroekonomi	1x4	4
11.2	Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	1x4	4
11.3	Kërkime Operacionale	1x4	4
11.5	Statistike	1x4	4
<b>11T</b>	<b>Totali i pikëve për skriptë interne</b>		<b>16</b>
<b>12</b>	<b>Recenzent në tekst universitar</b>		
12.1	Liber botuar nga autor: Ekonometri – Besa Xhaferi	1x4	4
<b>12T</b>	<b>Totali i pikeve nga recenzimet e teksteve universitare</b>		<b>4</b>
<b>13</b>	<b>Anëtarë i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës – Cikli i parë i studimeve.</b>		
13.1	Anëtare komisioni për vlerësim ose mbrojtje të temave deridiplomike në Fakultetin ekonomik, në 15 komisione	15x0.2	3
<b>13T</b>	<b>Totali i pikëve nga anëtarësimet në komisione</b>		<b>3</b>
<b>14</b>	<b>Mentor dhe anëtar në mbrojtje punimi të diplomës në studime të ciklit të parë dhe të dytë</b>		
14.1	Mentor në 6-të tema punime diplomash të mbrojtura në Fakultetin Ekonomik	6x0.2	1.2
14.2	Anëtare komisioni për vlerësim ose mbrojtje të temave Master në Fakultetin Ekonomik, në 10 komisione	10x1=10	10
<b>14T</b>	<b>Totali i pikeve nga mentorimet dhe anëtarësimet për mbrojtje të temave në ciklin e parë dhe të dytë</b>		<b>11.2</b>
<b>15</b>	<b>Viziting profesor jashtë vendit</b>	8	
15.1	Universiteti në Novi Sad, Fakulteti ekonomik i Suboticës, Disperzimi në Bujanoc, viti 2020.		8
15.2	Universiteti i Ljublanes, Fakulteti ekonomik, thirrja 2020/21-2024/24		8
<b>16</b>	<b>Totali i pikëve në mësimdhënie dhe veprimtari arsimore</b>		<b>94.53</b>

<b>II. VEPRIMTARIA SHKENCORE HULUMTUESE</b>			
Numri rendor	Emri i aktivitetit	Pikët e kalkuluar	Pikët në total
1	Mentor në vijim në punim të magistraturës		
1.1	Mentor në vijim në një temë të magistraturës në F. Ekonomik, kandidati Fitore Xhemaili	1x2	2



1T	<b>Totali i pikeve nga angazhimi mentorial ne punim magjistrature</b>		<b>2</b>
2	PUNIME ME REZULTATE SHKENCORE ORIGJINALE NË REVISTË TË NJOHURA SHKENCORE PROFESIONALE ME BORD EDITORIAL NDËRKOMBËTAR: Punime (Referencat: Chicago style)	<b>6</b>	
2.1	<b>Dauti, B. (2016).</b> Trade and foreign direct investment: Evidence from South East European countries and New European Union member states Proceedings of Rijeka Faculty of Economics: Journal of Economics and Business, 34(1), 63-89. <i>Indexed in web of science</i>	6	6
2.2	<b>Dauti, B; et al., (2017)</b> "Insolvency risk prediction using the logit and logistic models: some evidences from Romania." Economic Computation & Economic Cybernetics Studies & Research 51, no. 4 <i>Indexed in web of science</i>	6×0.6	3.6
2.3	<b>Dauti, B; et al (2020).</b> Cyclicity of Fiscal Policy in the European Union. <i>Romanian Journal of Economic Forecasting</i> , 23(1), p.75. <i>Indexed in web of science</i>	6×0.6	3.6
2.4	<b>Dauti, B. (2018).</b> Substitutionary or complementary relationship between foreign direct investment and exports. Evidence from transition countries. <i>Economic Vision, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism</i> , 5(9-10), 20-30. <i>Indexed in EBSCO, google scholar</i>	4×1	4
2.5	<b>Dauti, B., &amp; Emini, E. (2019).</b> Economic challenges of North Macedonia is bridging toward European Union, with focus on real and nominal convergence. <i>ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism</i> , 6(11-12), 31-41. <i>Indexed in EBSCO, google scholar</i>	4×0.9	3.6
2.6	<b>Dauti, B. (2020).</b> Institutional determinants of foreign direct investment flows in transition economies. <i>Economic vision-International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism</i> , 7(13-14), 71-86. <i>Indexed in EBSCO, google scholar</i>	4×1	4
2T	<b>Totali i pikëve nga punimet me rezultate origjinale</b>		<b>24.8</b>
3	<b>PJESËMARRJE NË TUBIME SHKENCORE NDERKOMBETARE ME REFERAT</b>	<b>2</b>	
3.1	<b>Dauti, B., &amp; Emini, E. (2019).</b> Economic challenges of North Macedonia is bridging toward European Union, with focus on real and nominal convergence. <i>6<sup>th</sup> International Scientific Conference: "Economic Development as a precondition for EU integration"</i> EDPEUI2018.	2×1	2
3.2	<b>Dauti, B (2019).</b> Fiscal Policy Cyclicity in the South East European Countries. <i>International Congress on Human, Social Sciences and Arts.</i>	2×1	2

3.3	<b>Dauti, B (2017).</b> <i>Estimating Export Potentials in Transition Countries. 5th International Scientific Conference. Challenges of Doing Business in Contemporary World. ISCFEFBA2017. University of Tetova, Faculty of Economics.</i>	2×1	2
<b>3T</b>	<b>Totali i pikëve nga pjesëmarrjet në tubime shkencore</b>		<b>6</b>
4	Abstrakte të publikuar në librin e përmbledhjeve të konferencave ndërkombëtare	1	
4.1	<b>Dauti, B., &amp; Emini, E. (2019).</b> Economic challenges of North Macedonia is bridging toward European Union, with focus on real and nominal convergence. <i>6<sup>th</sup> International Scientific Conference: "Economic Development as a precondition for EU integration"</i> EDPEUI2018.	1×1	1
4.2	<b>Dauti, B (2017).</b> <i>Estimating Export Potentials in Transition Countries. 5th International Scientific Conference. Challenges of Doing Business in Contemporary World. ISCFEFBA2017. University of Tetova, Faculty of Economics.</i>	1×1	1
4.3	<b>Dauti, B (2019).</b> <i>Fiscal Policy Cyclicity in the South East European Countries. International Congress on Human, Social Sciences and Arts. Faculty of Economics, University of Tetova.</i>	1×1	1
4T	Totali i pikëve nga abstraktet e publikuara në librin e përmbledhjeve të konferencave ndërkombëtare		<b>3</b>
5	PANELIST NË TUBIM SHKENCOR/PROFESIONAL	<b>2</b>	
5.1	Panelist në sesionin e Ekonomi-Biznes, "Economic Development as a Precondition for EU Integration", University of Tetova, 19/20 October, 2018		2
5.2	Panelist në sesionin e Ekonomi-Biznes, "Challenges of Doing Business in the Contemporary World", University of Tetova, 01, December, 2017		2
5.3	Panelist në Sesionin e Ekonomi-Biznes, "1 st International Congress on Tourism, Economic and Business Sciences", University of Tetova, 02, Novembar, 2017.		2
5.4	Panelist në Sesionin e Ekonomi-Biznes, "The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkans", University of Tetova, 02 December, 2016.		2
5T	Totali i pikëve nga pjesëmarrjet në panele konferencash		<b>8</b>
6	LIGJËRATË PLENARE NË MBLEDHJE SHKENCORE OSE PROFESIONALE ME PJESËMARRJE NDËRKOMBËTARE	3	
6.1	<b>The Berghof Foundation and the Southeast Europe Association: Bardhyl Dauti (2017): Referring on the topic: Media Reforms in Macedonia, July 2017; Ljubljana, Slovenia</b>	1×3	3
6.2	<b>The Berghof Foundation and the Southeast Europe Association: Bardhyl Dauti (2017): Referring on the</b>	1×3	3

	<i>topic: Euro-Atlantic Integration of Macedonia, November 2017, in Potsdam, <b>Berlin, Germany</b></i>		
6.3	<b>The Berghof Foundation and the Southeast Europe Association:</b> <i>Bardhyl Dauti (2018): Referring on the topic: Imagining New Paths to a Prosperous Macedonia’ workshop series, May 2018, <b>Vienna, Austria</b></i>	1×3	3
6.4	<b>Conference on investment on medicinal cannabis, London – United Kingdom:</b> <i>Bardhyl Dauti (2019): Speaker as a panelist; Topic: Investing in Europe: what is the perception of the European market by international companies looking to invest in it: <b>Cannabis Europa London, South Bank Center, London, United Kingdom</b></i>	1×3	3
6.5	<b>Horasis Global Meeting, leadership event – Cascais, Portugal.</b> <i>Topic: Catalyzing the benefits of globalization – The future of innovation in globalized world. <b>Cascais – Portugal.</b></i>	1×3	3
<b>6T</b>	<b>TOTALI I PIKEVE NGA LIGJERATAT PLENARE (SEKSIONI 7)</b>		<b>15</b>
7	<b>LIGJERATE E MBAJTUR ME THIRRJE NGA UNIVERSITETI</b>	2	
7.1	<i>Bardhyl Dauti (2018): Guest speaker on the international scientific conference: “Economic Development as a prediction for EU Integration”. Faculty of Economics, University of Tetovo (19 October 2018).</i>	1×2	2
7.2	<i>Bardhyl Dauti (2019) Guest speaker on 7th International Scientific Conference “Contemporary Economic Trends”, 2019, Tetova, Republic of North Macedonia</i>	1×2	2
7.3	<i>Bardhyl Dauti (2020): Referring on the topic: The impact of pandemic COVID-19 on the national economy, 22 May; Faculty of Economics, University of Tetovo, Tetovo, North Macedonia.</i>	1×2	2
<b>7T</b>	<b>TOTALI I PIKËVE NGA SEKSIONI 8</b>		<b>6</b>
8	<b>LIGJËRATË E MBAJTUR ME THIRRJE NGA NDONJË UNIVERSITET I HUAJ – ME RENOME NDËRKOMBËTARE</b>	3	
8.1	<i>Bardhyl Dauti (2020): Guest lecture on the topic: Recreation and Tourism Economics, at the <b>University of Illinois at Urbana Champaign, U.S.A.</b></i>	1×3	3
<b>8T</b>	<b>TOTALI I PIKEVE NGA SEKSIONI 9</b>		<b>3</b>
<b>10 = SUM (1T:8T)</b>	<b>TOTALI I PIKËVE NGA VEPRIMTARIA SHKENCORE HULUMTUESE</b>		<b>67.8</b>

<b>III</b>	<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE</b>	
1	Dauti, Bardhyl (2020). Fiscal Policy of the European Union, in Qorraj, G. & Hashi, I. (eds). European Union and the Western Balkans. (kapitull libri: Autor)	3
2	Evalum të 6 punimeve shkencore të dorëzuara për publikim në revistën: <i>Economic Vision</i> , International Scientific Journal	6 x 2 =12

	in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and <i>Tourism</i> , 6(Vëllimi 6)	
2	Koordinator në përgatitje të elaboratit për programin studimor Ekonomi-Biznes, Fakulteti Ekonomik, 2021	2
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria profesionale-aplikative</b>	<b>17</b>
<b>IV</b>	<b>VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË</b>	
<b>1</b>	<b>Anëtar Bordi shkencor ose organizativ në tubim shkencor / profesional / konferencë</b>	<b>1</b>
1.1	Anëtar i bordit shkencorë të Konferencës së 4-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkans”, 2016, Universiteti i Tetovës.	1
1.2	Anëtar i bordit shkencorë të Konferencës së 6-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “Economic development as a precondition for EU integration”, 2018, Universiteti i Tetovës.	1
1T	Totali i pikëve nga anëtarësimet në border shkencore ose organizative në tubime shkencore/ konferenca.	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Anëtar Bordi organizativ në revistë shkencore/profesionale.</b>	
2.1	Anëtare në Bordin shkencorë të revistës Economic vizion, vol.4, nr. 7 dhe 8, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2017.	1
2.2	Anëtare në Bordin shkencorë të revistës Economic vizion, vol.5, nr. 9 dhe 10, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2018.	1
2.3	Anëtar në Bordin shkencorë të revistës Economic vizion, vol.6, nr. 11 dhe 12, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2019.	1
2T	<b>Totali i pikëve nga anëtarësimet në bordet shkencore në revista shkencore.</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	<b>Anëtar komisioni për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore.</b>	
3.1	Anëtar komisioni për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje asistent (dy kandidat) dhe docent (një kandidat).	3 x 0.5 = 1.5
3T	<b>Totali i pikëve nga anëtarësimet në komisione për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje mësimore/shkencore.</b>	<b>1.5</b>
<b>4</b>	<b>Anëtar në trupa profesional</b>	<b>2</b>
4.1	Anëtar i forumit ndërkombëtar për hulumtime në tregti ndërkombëtar; F.R.E.I.T (Forum for research in empirical international trade).	2
4.2	Anëtar i komisionit parlamentar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për asocim dhe stabilitet i Republikës së Maqedonisë, viti 2016.	2
4.3	Anëtar i komisionit për çështje ekonomike në qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti 2018.	2
4T	<b>Totali i pikëve nga anëtarësimet në trupat profesional</b>	<b>6</b>
<b>IV</b>	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria me interes më të gjerë</b>	<b>12.5</b>

<b>FORMULARI I PIKEVE NË TOTAL</b>		
I	Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore – arsimore	<b>94.53</b>
II	Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore hulumtuese	<b>67.8</b>
III	Totali i pikëve nga veprimtaria profesionale aplikative	<b>17</b>
IV	Totali i pikëve nga veprimtaria me interes më të gjerë	<b>12.5</b>
	<b>Totali i pikëve (I+II+III+IV)</b>	<b>191.83</b>

## **RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më: 10.04.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Pecat”, si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), Këshillit mësimor-shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më datë, 21.04.2021, solli vendim me numër 14-390/1 për caktim të komisionit recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi, për lëndët: **E Marketing, Etika Afariste, Komunikimi Afarist** (në programet studimore: Marketing - Menaxhment Ekonomi Biznes, Financa Kontabilitet), në përbërje:

1. Prof. Dr. Brikend Aziri, profesor inordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, kryetar,
2. Prof. Dr. Jasna Teofilovska, profesor inordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, anëtar,
3. Prof. Dr. Sheherzade Murati, profesor inordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, anëtar.

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë konstatoi se ka aplikuar vetëm kandidatja **Doc. Dr. Almira Curri Memeti**, dhe pasi që dosja e aplikimit e përmban të gjithë dokumentacionin e paraparë në konkurs, vendos që të paraqet këtë:

### **RECENSION**

Me datë 10.04.2021 në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Pecat” si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Ekonomik për lëndët: **E Marketing, Etika Afariste, Komunikimi Afarist** (në programet studimore: Ekonomi dhe Biznes, Financa Kontabilitet, Marketing-Menaxhment).

Komisioni në fjalë, pasi kontrollon materialet e dorëzuara, konstatoi se në konkurs si kandidat i vetëm është paraqitur **Docent. Dr. Almira Curri Memeti** e punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, si **docent** në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

## I. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Dr. Almira Curri-Memeti është e lindur më 28.01.1984 në Shkup, ku edhe e kreu shkollën fillore, ndërsa arsimin e mesëm e mbaroi në vitin 2002 në shkollën “Zef Lush Marku” në Shkup, drejtimi matematiko-natyror. Kandidatja studimet i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik, nga fusha Menaxhment financiar në Universitetin Shën Qirili dhe Metodi në Shkup me notë mesatare 8.10.

Studimet e magjistraturës i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin Shën Qirili dhe Metodi në Shkup, ashtu që, në vitin 2010 me sukses mbron punimin e magjistraturës me temë **“Komunikimi afarist në biznes”**, me notë mesatare 8.56 dhe merr titullin **magjistër nga fusha e MBA menaxhmentit në Universitetin Shën Qirili dhe Metodi në Shkup**.

Kandidatja në vitin 2011, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi” të Shkupit, paraqet tezën e doktoraturës me titull: **“Biznesi virtuel – dimenzioni lokal, global dhe social”**. Pas përfundimit dhe mbrojtjes me sukses të disertacionit të doktoraturës më datë: 20.04.2015, ajo merr titullin shkencor **Doktor i Shkencave Ekonomike**.

Dr. Almira Curri-Memeti gjatë vitit akademik 2010/11 ka qenë e angazhuar *asistent* në Fakultetin Ekonomik në marrëdhënie jo të rregullt pune, ndërsa që nga viti akademik 2011-2012, është në marrëdhënie të rregullt pune si *bashkëpunëtor në thirrjen asistent* në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës. Kandidatja Doc. Dr. Almira Curri Memeti është e zgjedhur në thirrjen mësimore shkencore *docent* në vitin 2016.

## II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Veprimtaria mësimore arsimore e kandidates Doc. Dr. Almira Curri Memeti është shumë e begatshme dhe e frytshme. Në fakt, kandidatja në fjalë ka një përfshirje në mësimdhënie si brenda po ashtu edhe jashtë vendit si viziting profesor. Përpos lëndëve E Marketing, Etika Afariste, Komunikimi Afarist, ku ka qenë e zgjedhur në thirrje mësimore shkencore Docent, ajo ka realizuar mësimdhënie edhe në lëndë të tjera, në të gjitha ciklet e studimit. Lëndët të cilët i ka ligjëruar në ciklin e parë si, E Marketing, Etika Afariste, Komunikimi Afarist janë fushat e ngushta ku kandidatja ka kontribuar në përgatitjen dhe ngritjen profesionale të studentëve. Kandidatja,

gjithashtu ka një kontribut të madh edhe gjatë mentorimit të kandidatëve në studimet e ciklit të parë dhe merre pjesë edhe në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të temave deridiplomike.

Në ciklin e dytë kandidatja ka ligjëruar lëndët në vijim: E Marketing, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Ndërkombëtare dhe Marketingu në sektorin publik.

Kandidatja duke vazhduar të realizoj me përgjegjësi maksimale detyrimet pedagogjike në ciklin e dytë, përpos mentorimit të kandidatëve, merë pjesë edhe në shumë komisione për vlerësim dhe mbrojtje të temave të magistraturës në Fakultetin ekonomik.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Doc. Dr. Almira Curri Memeti ka realizuar gjithsejtë 138.64 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

### **III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e shkencave ekonomike.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur si më poshtë:

#### **A. Artikuj shkencorë**

1. Curri Memeti A. (2020) **“MYSTERY SHOPPING - A PROCESS OF UNDERSTANDING CONSUMERS, WHICH OPENS UP THE SPACE FOR CREATING CONTEMPORARY COMPETITIVE TRENDS”**, *Economic Vision, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, vol. 7 13-14/2020, ISSN 2545- 4544, pp. 22-27



2. Curri Memeti A. (2020) **“TRUST IN VIRTUAL ORGANIZATIONS”** *International Journal of Economics, Business, Marketing and Management, Bas Bitola*, vol. 6, ISBN 978-608-4729-08-2, pp. 14-21
3. Curri Memeti A. and Selimi D. (2020) **“GREEN HUMAN RESOURCE MANAGEMENT - PERFORMANCE MANAGEMENT AND EVALUATION”**, *International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, Faculty of Economics-Skopje - SS. Cyril and Methodius University in Skopje, vol. 1, EBSTF-20\_PAPER\_53, pp. 395-402.
4. Curri Memeti A. and Amzai A. (2018) **“TECHNOLOGICAL CHANGES AND GLOBALIZATION AS THE MAIN PREDISPOSITION TO ENTREPRENEURIAL ACTIVITY”**, *International Journal of Economics, Business, Marketing and Management, Bas Bitola*, vol. 5, ISBN 978-608-4729-08-2, pp. 29-38
5. Curri Memeti A. (2018) **“HUMAN CAPITAL MANAGEMENT IN CONDITIONS OF GLOBALIZATION”** - Economic Vision, *International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism*, vol.5 9-10/2018, ISSN 2545-4544, pp. 116-128
6. Curri Memeti A., Bexheti GJ. and Kovaqi S. (2017) **“MANAGING ONLINE REPUTATION THROUGH SOCIAL MEDIA”** - *International Journal of Economics, Business, Marketing and Management, Bas Bitola*, vol. 4, ISBN 978-608-4729-06-8, pp. 539-550

## **B. Tubime shkencore**

1. Curri Memeti A. **“The development of information and communication technology in companies in Macedonia, a condition for greater competitiveness on the market”**, has participated in the 5-th International Scientific Conference, Faculty of Economic & Faculty of Business Administration of The University of Tetova, “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”, Tetovo, 2017.

2. Curri Memeti A. **“The role of intellectual capital in business, opportunities reducing it’s number of departures from the country”** - has participated in the 4-th International Scientific Conference, Faculty of Economic & Faculty of Business Administration of The University of Tetova, “The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkans”, Tetovo, 2016.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Doc.Dr.Almira Curri-Memeti ka realizuar gjithsejtë 31.2 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

#### **IV. VEPRIMTARIA E APLIKUAR PROFESIONALE**

Veprimtaria e aplikuar profesionale e kandidates Doc.Dr. Almira Curri Memeti, mund të përfshihet në:

- Anëtare në komisionin për përgatitjen e elaborateve të programeve studimore të ciklit të parë të Fakultetit Ekonomik;
- Anëtare në komisionin për përgatitjen e elaborateve të programeve studimore të ciklit të dytë të Fakultetit Ekonomik;
- Pjesëmarrës në komisione të ndryshme promovuese dhe projekte qeveritare;
- Promovim i Fakultetit Ekonomik për vitin akademik 2019/20.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Doc.Dr.Almira Curri-Memeti ka realizuar gjithsejtë 3.00 pikë nga veprimtaria e aplikuar profesionale.

#### **V. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË**

##### **1.Anëtarë në Bordin shkencor ose organizativ në tubim shkencor/profesional/konferencë**

- ✚ Anëtare e këshillit organizues të Konferencës së4-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkans”, 2016, Universiteti i Tetovës.
- ✚ Anëtare ekëshillit organizues të Konferencës së 5-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”, 2017, Universiteti i Tetovës.
- ✚ Anëtare e këshillit organizues të Konferencës së 6-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “Economic development as a precondition for EU integration”, 2018, Universiteti i Tetovës.
- ✚ Anëtare e këshillit organizues të Konferencës së 6-të Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik, “Contemporary economic trends”, 2019, Universiteti i Tetovës.

##### **2.Anëtarë në Bordin shkencor ose organizativ në revistë shkencore/profesionale**

- ✚ Anëtare në Bordin organizativ të revistës Economic vizion, vol.3, nr.5 dhe 6, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2016.
- ✚ Anëtare në Bordin organizativ të revistës Economic vizion, vol.4, nr.7 dhe 8, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2017.
- ✚ Anëtare në Bordin organizativ të revistës Economic vizion, vol.5, nr.9 dhe 10, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2018.
- ✚ Anëtare në Bordin organizativ të revistës Economic vizion, vol.6, nr.11 dhe 12, Revistë shkencore e Fakultetit ekonomik, botimi i vitit 2019.

### **3. Koordinator për proekte të Fakultetit Ekonomik**

-Kordinatore e proekteve në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tetovës, 2018-

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Doc. Dr.Almira Curri-Memeti ka realizuar gjithsejtë 14.00 pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.

## VI.FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja Doc. Dr.Almira Curri-Memeti ka grumbulluar gjithsej 186.84 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore 138.64 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 31.2 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative 3.00 pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 14.00 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKË</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	138.64
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	31.2
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	3.00
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	14.00
<b>Gjithsej</b>	<b>186.84</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja Doc. Dr. Almira Curri-Memeti në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), ka grumbulluar gjithsejtë **186.84** pikë nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Inordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatës, Komisioni Recensues konstaton se: Doc. Dr. Almira Curri-Memeti posedon cilësi shkencore-profesionale dhe në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ajo i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që kandidatja Dr. Almira Curri-Memeti të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore INORDINAR për lëndët: **E Marketing, Etika Afariste dhe Komunikimi Afarist** (në programet studimore: Ekonomi Biznes, Financa dhe Kontabilitet, Marketing-Menaxhment dhe Turizëm).

Tetovë, Prill 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Brikend Aziri

---

2. Prof. Dr. Jasna Teofilovska

---

3. Prof. Dr. Sheherzade Murati

---

## **S H T O J C Ë**

### **PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

**Kandidatja:** Almira Nejazi Curri Memeti  
(emri, emri i prindërit dhe mbiemri)

**Institucioni:** Fakulteti Ekonomik-UT, Tetovë  
(emri i fakultetit/institucioni)

**Lëmia shkencore:**

I. **VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

<b>1. Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore</b>		
<b>Aktiviteti</b>	<b>Kalkulimi</b>	<b>Pikët</b>
<b>Ligjërata të realizuara në ciklin e parë</b>		
<b>Viti akademik 2016/2017 – Semestri dimëror</b>		
<i>Programi studimor Ekonomi dhe biznes</i>		
Etika Afariste / Sem. V, (3+1)	3×15×0.04	1.8
<i>Programi studimor Marketing dhe menaxhment</i>		
E Marketing / Sem. VII, (4+2)	4×15×0.04	2.4
<i>Programi studimor Financa dhe kontabilitet</i>		
Menaxhimi investimeve / Sem. V, (4+2)	4×15×0.04	2.4
<b>Viti akademik 2016/2017 – Semestri verorë</b>		
<i>Programi studimor Ekonomi dhe biznes</i>		
Menaxhimi Investimeve / Sem. VI, (3+1)	3×15×0.04	1.8
<i>Programi studimor Marketing dhe menaxhment</i>		
Menaxhimi i Investimeve / Sem. VI, (3+1)	3×15×0.04	1.8
